



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 159 Prot.

Tiranë, më 24.05.2016

V E N D I M
Nr. 60, datë 24.05.2016

**Mbi përfundimin e procesit të verifikimit,
filluar me Urdhrin nr. 159/1 prot., datë 17.03.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104, të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Këshillin e Qarkut Shkodër, për rastin e nëpunësve të këtij institucioni,
*****,

VËREJ SE :

Mbi bazën e informacionit të përcjellë nga punonjësit ***** të Këshillit të Qarkut Shkodër, rregjistruar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 159 prot., datë 19.02.2016, Komisioneri ka nxjerrë urdhërin e verifikimit, nr. 159/1 prot, datë 17.03.2016, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në lidhje me sqarimin e problematikës së pretenduar prej tyre, që ka të bëjë, me parregullsi gjatë procesit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit në këtë institucion.

Në zbatim të këtij akti, u krye hetimi i plotë administrativ, u administrua dokumentacioni pranë Këshillit të Qarkut Shkodër si dhe u vlerësua ligjshmëria e veprimeve administrative të kryera nga njësia përgjegjëse, në lidhje me ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil, për shkak ristrukturimi, të punonjësve ***** , në këtë institucion.

Nga analiza e akteve të administruara, rezulton se, punonjësit e Këshillit të Qarkut Shkodër janë vënë në dijeni për shkurtrimin e vendeve të punës, me anë të shkresës nr. 32 prot., datë 15.01.2016, *“Për fillimin e procedurës së ristrukturimit”*, të drejtuesit të institucionit. Më pas, me Urdhrin e Brendshëm nr.4, datë 18.01.2016, është ngritur Komisioni i Ristrukturimit.

Në vijim, Këshilli i Qarkut Shkodër, me Vendimin nr. 4, datë 30.01.2016, ka vendosur, miratimin e strukturës organizative të administratës së këtij institucioni, me 13 (trembëdhjetë) punonjës gjithsej, prej të cilëve 3 (tre) të zgjedhur dhe 10 (dhjetë) personel administrativ dhe nëpunës civil.

Në zbatim të detyrës së tij funksionale, Prefekti i Qarkut Shkodër, me shkresën nr. 104/2 prot., datë 12.02.2016, pas shqyrtimit të Vendimit nr. 4 datë 30.01.2016, të Këshillit të Qarkut Shkodër, ka miratuar strukturën dhe numrin e punonjësve në këtë institucion.

Sipas kësaj strukture, rezulton se, Këshilli i Qarkut Shkodër ka pësuar shkurtrim të numrit vendeve të punës, nga **31** pozicione, prej të cilave **23** të përfshira në shërbimin civil, që kishte struktura e mëparshme, në **13** pozicione, në strukturën e re, prej të cilave vetëm **8** pozicione pune, bëjnë pjesë në shërbimin civil.

Nisur nga sa më sipër konstatoj se, subjekti është përfshirë në procesin e ristrukturimit, pasi rezulton se ka shkurtrim të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të punës, sidomos të atyre që bëjnë pjesë në shërbimin civil, *(të cilat janë shkurtuar në masën, mbi 50%)*, si dhe riorganizim të tyre.

Duke analizuar veprimet dhe aktet e mësipërme administrative, konstatohet se procedura e kryer për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për ata punonjës pjesë e shërbimit civil, që u është shkurtuar apo ristrukturuar pozicioni i punës, është kryer në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në Kreun II dhe III, të Vendimit nr. 171, dt. 26.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”*.

Në zbatim të pikës 3 të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Komisioni i Ristrukturimit i Këshillit të Qarkut Shkodër, ka shqyrtuar gjithë mundësitë e sistemimit për secilin prej nëpunësve civilë, në vendet e lira të mbetura apo riorganizuar .

Në përfundim të shqyritimit nga ana e Komisionit të Ristrukturimit, nuk është gjetur asnjë mundësi për sistemimin e tyre. Në këto kushte, ka rezultuar se për këta punonjës Komisioni i Ristrukturimit i ka propozuar njësisë përgjegjëse, ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Mbi këtë bazë, Kryetarja e Këshillit të Qarkut Shkodër, ka nxjerrë aktin administrativ nr.110 prot., datë 15.02.2016, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për nëpunësit, për shkak të ristrukturimit.

Ky akt është nxjerrë duke respektuar rregullat dhe procedurën e parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, kreu III *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”*, i Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, i Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”* dhe Udhëzimit nr. 3, datë 14.04.2014, të Departamentit të Administratës

Publike *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit te ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*.

Në vijim të analizës vlerësoj se, pretendimet e ngritura nga punonjësit, se përbërja e Komisionit të Ristrukturimit nuk ka qenë e rregullt, pasi në të nuk është përfshirë njësia e burimeve njerëzore dhe për këtë shkak veprimtaria e tij nuk duhet vlerësuar e ligjshme, etj., nuk provohet nga aktet e administruara.

Në bazë të nenit 15, të ligjit nr. 147/2015, *“Për buxhetin e vitit 2016”*, është shënuar një shkurtim i ndjeshëm i fondit të pagave të institucionit, i cili ka passjellë edhe shkurtimin e numrit të punonjësve, të cilët do të kryejnë gjithë aktivitetin, për përmbushjen e misionit të institucionit. Nga ana tjetër, në strukturën e re nuk është parashikuar ekzistenca e njësisë së burimeve njerëzore, si njësi organizative më vete. Kjo detyrë i është ngarkuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Qarkut. Për këtë arsye, nëpunësja e mëparshme e burimeve njerëzore, pozicioni i të cilës ishte parashikuar të shkurtohej, nuk mund të ishte pjesë e Komisionit të Ristrukturimit, që do të kryente procedurën përkatëse ligjore.

Nga gjithë sa më sipër, arrij në përfundimin se, akti administrativ nr. 110 prot., datë 15.02.2016 (*sipas listës gjithsej 15 punonjës*), i Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër, për ndërprerjen e marrëdhënieve së punës për shkak të shkurtimit të vendeve të punës në këtë institucion, është nxjerrë duke respektuar kërkesat dhe procedurën e parashikuar nga neni 50, i ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; Kreu III, *“Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”* i Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”* dhe Udhëzimi nr. 3, datë 14.04.2014, i Departamentit të Administratës Publike *“Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit te ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”*. Në këto kushte, nuk është i nevojshëm investimi apo ndërhyrja e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për rregullimin e ligjshmërisë.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në nenin 16, pika 6, dhe 34, pika 1, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ, kryer mbi bazën e Urdhrit të Verifikimit nr.159/1 prot., datë 17.03.2016, *“Për verifikimin e informacionit në lidhje me, ligjshmërinë e veprimit administrativ, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës në shërbimin civil për shkak të ristrukturimit të institucionit , të disa punonjësve të Këshillit të Qarkut Shkodër, ndër të cilët *****”*.

2. Të njoftohen për këtë vendim, Këshilli i Qarkut Shkodër dhe ish punonjësit të këtij institucioni, ndër të cilët *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA